



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Për: Deputetët e Kuvendit;
Cc: Kryesia e Kuvendit;

Nga: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Lënda: Raport me rekomandime lidhur me Vendimin e Qeverisë nr. 05/105, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC;

Nr. 05/2440/Do-1201, datë: 20.9.2016;

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (më tutje Komisioni), në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20.9.2016, shqyrtoi Vendimin e Qeverisë nr. 05/105, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I. Kuvendi i Kosovës të miratojë propozimin e Qeverisë nr. 05/105, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC, ku Qeveria dhe KPMM, obligohen të sigurojnë se:

- (1) Sipërfaqja për eksplorim dhe eventualisht për eksploitim më vonë duhet të jetë e definuar dhe brenda kornizave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Miniera dhe minerale, Ligjin e Planifikimit hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtjen e mjedisit;
- (2) Kuvendi të merr vendim që Qeveria të obligohet që në kuadër të procedurave të mëtejme për të negociuar zbatimin eventual të projektit të hartojë studimin e fizibilitetit për këtë projekt, i cili do të definojë qartë kostot dhe përfitimet ekonomike dhe sociale, shanset që afron projekti dhe rrisqet eventuale dhe mundësitë e menaxhimit të tyre, sidomos lidhur me aspektet teknologjike, mjedisore (ujrat nëntokësore etj.) dhe ato të zhvillimit urban dhe koston oportune të projektit lidhur me ridestinimin e sipërfaqeve bujqësore dhe eventualisht zhvillimin e turizmit;
- (3) Studimi i fizibilitetit duhet të përcaktojë qartë ndikimet potenciale të projektit, efektet e jashtme sociale e ekonomike në zhvillimin hapësinor dhe urban, duke

- marrë parasysh afërsinë me zonat urbane dhe të banimit, efektet në vendbanime dhe zhvendosje të popullatës dhe në ujërat nëntokësore;
- (4) Patjetër, paraprakisht duhet të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor sipas metodologjisë së Bankës Botërore, si dhe të zbatohet një metodologji e standardeve të kësaj banke dhe të behën konsultime të gjithanshme me komunitetin lidhur me industrinë ekstraktive për këtë projekt;
 - (5) Kuvendi të merr vendim se duhet të definohet qartë procedura e shpronësimeve, si në fazën e hulumtimeve gjeologjike dhe pastaj eventualisht edhe për fazën eksploatimit në mënyrë që kjo të mos bjerë në barrë të buxhetit qendror;
 - (6) Të sigurohen garancitë e nevojshme financiare;
 - (7) Qeveria ta mbajë të informuar Kuvendin lidhur me zhvillimet në zbatimin e këtij projekti;
 - (8) Para marveshjës eventuale për realizimin e projektit të shfrytëzimit, Qeveria obligohet të sjell vendimin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Arsyetim


Në bazë të Ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158, me datë 25.8.2016 Qeveria ka nxjerrë Vendimin nr. 05/105 lidhur me propozimin e Ministrisë së Financave për miratimin e vendimit të Komitetit për Partneritet Publiko Privat me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC.

Komisioni analizoi raportin e përgatitur nga Komiteti Ndërmnistror për Partneritetin Publiko Privat dhe propozimin e Qeverisë lidhur me kërkesën e kompanisë Envidity dhe pas raportimit të Ministrit për Financa, më datë 13.9.2016, zhvilloi një debat të gjithanshëm në të cilin u vlerësua rëndësia e këtij projekti lidhur me vëllimin e investimve dhe sjelljen e teknologjive të avancuara. Krahas vlerësimit të rëndësisë së projektit dhe mundësive zhvillimore që do të mund të hapte, u vunë në dukje edhe nevoja që të analizohen qartë dhe me rigorozitet edhe rrisqet që mund ta përcjellin sidomos lidhur me efektet e gazifikimit nëntokësor në aspektin ndikimeve në ujërat nëntokësore, aspektin ndikimeve gjeofiziolgjike dhe gjeomorfologjike, aspekteve urbane dhe zhvillimit hapësinor dhe shfrytëzimit të tokës për banim ose për qëllime të tjera ekonomike, problemin e mbetjeve dhe rivitalizimit të mjedisit e tokës pas eksploatimit.

Gjithashtu u theksua nevoja e eksplorimit të përvojave në vendet e tjera lidhur me teknologjitë e gazifikimit nëntokësor të linjitet dhe efekteve të tija në aspektin e kostove dhe përfitimeve ekonomike e sociale, shanseve dhe rrisqeve. U insistua që hapësira e eksploatimit duhet të definohet qartë dhe brenda kufijve të Ligjit dhe Strategjisë për Miniera dhe minerale. Procedurat e konsultimeve me komunitetin dhe vlerësimi paraprak strategjik dhe mjedisor u theksua se duhet të bëhen sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të Bankës Botërore lidhur me industrinë minerare dhe ekstraktive.

Duke u nisur nga propozimi i Qeverisë dhe diskutimi në Komision, i propozohet Kuvendit që ta miratojë këtë vendim dhe që pjesë e këtij vendimi të jenë edhe rekomandimet e propozuara nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit,



Muhamet MUSTAFA